



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 167 Prot.

Gjirokastër, më 10/02/2022

V E N D I M

Nr. 01, datë 10/02/2022

PËR PLANIN VJETOR TË VEPRIMTARIVE AKADEMIKE
DHE KËRKIMORE-SHKENCORE

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 40 pika 4; të Statutit të Universitetit " Eqrem Çabej ", neni 23 pika 2/d dhe bazuar në planet e aktiviteteve të njësisë kryesore dhe Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakadematike Administrative me nr. 12 prot. të FE, nr.09 prot. të FESHSH, nr.06/1 prot. të FSHN, nr. 127/3 prot të DSHNA, Rektorati në mbledhjen e tij të datës, 11.02. 2022:

V E N D O S I :

1. Të miratojë projektplanin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore të UGJ-së;
2. Projektplani i përcillet Senatit Akademik për miratim;
3. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. dr. Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr 168 Prot.

Gjirokastër, më 10.02.2022

V E N D I M

Nr. 02, datë 10.02.2022

**PËR STRUKTURËN E PËRGJITHSHME TË UGJ-SË
DHE NUMURIN E PERSONELIT NË TË GJITHA NIVELET**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 40 pika 4; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 23 pika 2/C si dhe propozimet e FESHSH me nr.6/1, datë 21.01.2022, FSHN me nr. 4/1, datw 24.01.2022 dhe FE me nr. 9, datw 24.01.2022, Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 10.02.2022:

V E N D O S I :

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme të UGJ-së;
2. Të miratojë numurin e personelit të UGJ-së në të gjitha nivelet;
3. Struktura e përgjithshme të UGJ-së dhe numurin e personelit të UGJ-së në të gjitha nivelet i bashkëlidhet këtij vendimi;
4. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Senatit Akademik për miratim.

REKTORI

Prof. dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REKTORATI

Nr 169 Prot.

Gjirokastrë, më 10.02 /2022

VENDIM

Nr. 03, datë 10.02 . 2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2021 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2022**

Në zbatim të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 40, pika 4, Statutit të universitetit "Eqrem Çabej", neni 23 pika 2/f, Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 10.02 .2022;

V E N D O S I

1. Të miratojë raportin vjetor financiar për vitin 2021;
2. Të miratojë detajimin e buxhetit për vitin 2022;
3. Ky vendim i përcillet Senatit Akademik për miratim.

REKTOR


Prof.dr.Bektash MBMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr 170 Prot.

Gjirokastrë, më 10/02/2022

V E N D I M

Nr. 04, datë 10.02.2022

**PLANIFIKIMIN E KOHËS VJETORE TË PUNËS PËR PERSONELIN AKADEMIK
MIRATIMI I FORMATIT TË UNIFIKUAR NË RANG UNIVERSITETI PËR TEZËN E
PROVIMIT**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 40 pika 4, neni 59 pika 1; Statutit neni 23 pika 5; Rregullores së universitetit "Eqrem Çabej", neni 81 dhe neni 84; Rregullores së studimeve, neni 44; Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" dhe pas diskutimeve në Dekanate dhe strukturat ndihmës akademike të universitetit "Eqrem Çabej", Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 10.02.2022;

V E N D O S I :

1. Të miratoj modelin për planifikimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të miratojë formatin e unifikuar në rang institucioni të tezës së provimeve, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Një kopje e vendimit i përcillet strukturave të UGj-së.

REKTOR

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 234 Prot

Data 24 10 2022

VENDIM

Nr. 05, datë 24 02 .2022

PËR
LIRIMIN NGA DETYRA TË ZËVENDËS REKTORIT PËR KËRKIMIN
SHKENCOR DHE MARRËDHËNJET ME JASHTË

Në zbatim të nenit 39 pika 1 dhe nenit 40 pika 2 të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër nenet 30 dhe 31 dhe bazuar në vendimin e Senatit Akademik nr.05, datë 16.02.2022 "Për miratimin e kërkesës për dorëheqje të zëvendës rektorit për kërkimin shkencor dhe marrëdhënjet me jashtë", protokolluar me nr. 65, date 12.01.2022,

V E N D O S A

1. Të liroj nga detyra Zv/Rektoren për kërkimin shkencor dhe marrëdhënjet me jashtë, prof.as.dr. Valbona Duri;
2. Efektet financiare të prof.as.dr. Valbona Duri, në funksionin e sipërcituar ndërpriten në datën 28.02.2022;
3. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, prof.as.dr. Valbona Duri do të vazhdoj të jetë anëtare e personelit akademik të njësisë Bazë të Historisë, Gjeografisë dhe Antropologjisë;
4. Ky vendim i njoftohet prof.as.dr. Valbona Duri; Drejtorisë së Shqërbimeve Ndihmësakadematike Administrative, Drejtorisë së Shërbimeve Universitare për të zbatuar procedurat administrative dhe financiare; Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe Njësisë Bazë të Historisë, Gjeografisë dhe Antropologjisë, në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi;
5. Kërkesa e dorëheqjes protokolluar me nr. 65, datë 12.01.2022 dhe vendimi i Senatit Akademik nr.05, datë 16.02.2022 "Për miratimin e kërkesës për dorëheqje të zëvendës rektorit për kërkimin shkencor dhe marrëdhënjet me jashtë" i bashkëlidhen këtij vendimi;
6. Ky vendi hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 235 Prot

Data 24.02 2022

VENDIM

Nr. 06, datë 24.02.2022

PËR
EMËRIMIN E ZËVENDËS REKTORIT PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE
MARRËDHËNJET ME JASHTË

Në zbatim të nenit 39 pika 1 dhe nenit 40 pika 2 të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë nenet 30 dhe 31 dhe bazuar në vendimin e Senatit Akademik nr.06, datë 16.02.2022,

VENDOSA

1. Të emëroj prof.as.dr. Merita Isaraj në detyrën Zv/Rektorit për kërkimin shkencor dhe marrëdhënjet me jashtë;
2. Efektet financiare të prof.as.dr. Merita Isaraj, në funksionin e sipërcituar fillojnë në datën 01.03.2022;
3. Ky vendim i njoftohet prof.as.dr.Merita Isaraj; Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës-Akademike Administrative, Drejtorisë së Shërbimeve Universitare për të zbatuar procedurat administrative dhe financiare;
4. Ky vendi hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR


Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 648 Prot.

Gjirokastrë, më 03/06 /2022

VENDIM

Nr. 07, datë 03.06. 2022

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT NË KUADËR TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA
BORDI I AKREDITIMIT

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Rëpublikën e Shqipërisë"; neni 23 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; Vendimit të Bordit të Akreditimit nr. 55, datë 16.12.2021 "Akreditimi periodik i institucionit të arsimit të lartë Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si dhe referuar vendimeve: nr. 5 prot., datë 02.06.2022 të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore; nr. 3 prot., datë 20.05.2022 të Fakultetit të Shkencave të Natyrës; nr. 3 prot., datë 03.06.2022 të Fakultetit Ekonomik, Rektorati në mbledhjen e datës 03.06.2022,

VENDOSI;

1. Të miratojë planin e veprimit në përmbushje të rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit për akreditimin periodik institucional sipas tabelës bashkëlidhur".
2. Vendimi i përcillet për miratim Senatit Akademik të UGJ-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Prof.dr Bektash MEMA

REKTOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 201 Prot

Datë 16.06 2022

VENDIM

Nr. 08, datë 16.06 2022

**PËR MIRATIMIN E "AKT-MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI" MIDIS
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR DHE FAKULTETIT HISTORI-
FILOLOGJI TIRANË**

Bazuar nenin 39 pika 4 të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 23 pika 2/h të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Rektorati në mbledhjen e tij të datës 16.06.2022, diskutoi "Akt-Marrëveshje Bashkëpunimi" midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Fakultetit Histori-Filologji Tiranë me objekt "Organizimi i shkollës verore-Oral History" dhe

VENDOSI

1. Të miratojë marrëveshjen dhe vlerësimin buxhetor të realizimit, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
2. Vendimi, marrëveshja dhe vlerësimi buxhetor i përcillen Senatit Akademik për miratim;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR


Prof.dr.Bektash MEHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
REKTORATI

Nr. 1414 Prot

Datë 08.11 2022

VENDIM

Nr. 09, datë 08.11 2022

PËR KOHËZGJATJEN E STUDIMEVE

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 90; Statutit të Universitetit "Eqrem Cabej", neni 73; Rregullores së Universitetit "Eqrem Cabej", neni 64; Rregullores së Studimeve të Universitetit "Eqrem Cabej", neni 18; propozimin e FESHSH nr. 102, datë 07.11.2022; propozimin e FSHN nr. 113, datë 08.11.2022; propozimin e FE nr. 100, datë 08.11.2022. Rektorati i Universitetit "Eqrem Cabej", në mbledhjen e tij të datës, 08.11. 2022 ;

VENDOSI:

1. Kategoria e studentëve, që kanë filluar studimet nga viti akademik 2016-2017 e në vazhdim dhe që janë pajisur me numur matrikullimi, por kanë qënë pasivë, numërimi i periudhës së kohëzgjatjes së studimeve (dyfishi i kohëzgjatjes normale), të filloj prej vitit akademik kur studenti bëhet aktiv.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm.

REKTOR

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
REKTORATI

Nr 1418 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 10, datë 08.11 2022

**PËR MIRATIMIN E FORMËS SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" NË FINANCË KONTABILITET**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, dhe akteve nënligjore në fuqi, udhëzimit nr. 14 datë 21.06.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10 datë, 30.03.2020, për përcaktimin e elementëve përbërës, formës së diplomës, ose certifikatës të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", dhe vendimit të Fakultetit Ekonomik nr. 09, datë 07.11.2022, Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 08.11.2022;

VENDOSI:

1. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit në ciklin e dytë "Master i Shkencave" në Financë Kontabilitet;
2. Vendimi i FE dhe formati i diplomës i bashkëlidhen këtij vendimi;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
4. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm.

REKTOR

Prof.dr.Bektash MEMLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
REKTORATI

Nr 1419 Prot

Datë 08.11 2022

VENDIM

Nr. 11, datë 08.11 2022

PËR MIRATIMIN E MODULEVE NË KUADRIN E PROJEKTIT EntrAL

Bazuar nenin 40 pika 4 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenin 23 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoi për akreditimin e moduleve të trainimit të stafit akademik dhe të studentëve të UGJ-së në kuadrin e projektit të BE EntrAL dhe

VENDOSI

1. Të miratoj akreditimin e modulit për trainimin e stafit akademik të UGJ-së;
2. Të miratoj akreditimin e modulit për trainimin e studentëve të UGJ-së, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
3. Qendra e të mësuarit gjatë gjithë jetës, LLL, të realizoj integrimin e këtyre moduleve;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
5. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm.

REKTOR

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
REKTORATI

Nr. 1420 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 12, datë 08.11 2022

**PËR PERSONELIN AKADEMIK ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME DHE
PERSONELIN AKADEMIK TË FTUAR, ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR**

Bazuar nënin 40 pika 4 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nënin 30 pika 1/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej, shkresën nr.93 të FESHSH, shkresën nr.79 të FSHN, shkresën nr.93 të FE si dhe me propozim të Rektorit, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoi për personelin akademik me kohë të pjesshme dhe të ftuar, me kohëzgjatje të caktuar që do të angazhohet për vitin akademik 2022-2023,

VENDOSI

1. Të miratoj personelin akademik të ftuar, sipas propozimeve të njëjësive kryesore, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm.

BEKTOR

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 1421 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 13, datë 08.11 2022

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR DHE QËNDRËS BALANCE TIRANË**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 39 pika 4; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 23; draftin e paraqitur nga FESHSH dhe FE, Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 08.11. 2022 ;

VENDOSI:

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrës dhe Qendra Balance Tiranë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm.

REKTOR

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
REKTORATI

Nr. 14/22 Prot

Datë 08/11 2022

VENDIM

Nr. 14, datë 08.11 2022

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË QENDRËS UNIVERSITARE NDËRDISIPLINORE
TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT**

Bazuar nenin 40 pika 4 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenin 23 pika 2/b të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, diskutoj projektstatutin e Qendrës Universitare Ndërdisciplinore të Kërkimit dhe Zhvillimit dhe,

VENDOSI

1. Të miratoj draftstatutin e Qendrës Universitare Ndërdisciplinore të Kërkimit dhe Zhvillimit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm.

REKTOR

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
REKTORATI

Nr. 1592 Prot

Datë 30/11 2022

VENDIM

Nr. 15, datë 30.11.2022

PËR
REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023

Në zbatim të ligjit 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" nenet: 72,74 dhe 76; të statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 23, Rektorati i universitetit "Eqrem Çabej" në datën 30.11. 2022, bazuar në dokumentacionin e sjellë nga njësitë kryesore për regjistrimin e studentëve sipas programeve dhe cikleve të studimit, për vitin akademik 2022-2023,

VENDOSI

1. Të miratoj regjistrimet për vitin akademik 2022-2023, konformë kuatoave të sjella nga njësitë kryesore;
2. Të miratoj numurin minimal të studentëve të regjistruar në një program studimi jo më pak se 10 (dhjetë);
3. Të shpall joaktiv për vitin akademik 2022-2023 për shkak të mosregjistrimeve këto programe studimi:
 - a) Bachelor në histori dhe gjuhë italiane;
 - b) Bachelor në matematikë-informatikë;
 - c) Master në AMU në matematikë-fizikë;
 - d) Master në AMU në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek;
 - e) Master në AMU në gjuhë dhe qytetërim Italian.
4. Vendimi, të cilit i bashkëlidhen informacionet e sjella nga njësitë kryesore përkatëse i përcillet Senatit Akademik për procedim të mëtejshëm;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV/REKTOR
Prof.dr.Jaho/CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR
REKTORAT

Nr. 1715 Prot

Datë 20/12 2022

VENDIM

Nr. 16, datë 20.12 2022

PËR

FORMAT E VLERËSIMIT NË SISTEMIN SHQIPTAR DHE EUROPIAN

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 40 pika 4; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 23 pika 2/g; Rregullores së Univrsitetit "Eqrem Çabej", neni 89 pika 1, Rektorati pasi mori në analizë propozimin "Për format e vlerësimit në sistemin shqiptar dhe europian" përgatitur nga Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Korrikulave, me objektiv për të konvertuar vlerësimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë në sistemin shqiptar të vlerësimit

VENDOSI

1. Të miratoj modelin e formës së vlerësimit në sistemin shqiptar dhe europian;
2. Modeli i bashkëlidhet këtij vendimi;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Senatit Akademik për miratim.

REKTOR

Prof.dr.Bektash MEMA

